

STATUT
I
SHOQERISE

EMAV GROUP SH.P.K

KREU I-re

Dispozita te Pergjitheshme

NENI 1. Data, themelimi, emrat e themeluesve.

Sot me date 01/08/2022 ne themeluesit krijojme Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar me emrin **EMAV GROUP SH.P.K**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **EMAV GROUP Sh.p.k**, eshte themeluar sipas kontrates dhe ne pershtatje te ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga 3 (tre) ortakë :

Artur FARRUKU, atesia Enver, lindur ne Manez - Durres me 29/07/1972 dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga Karta e Identitetit me nr.leternjoftimi 034841952 dhe nr. Personal H20729138W

Alban FARRUKU, atesia Enver, lindur ne Manez - Durres me 23/11/1975 dhe banues ne Manez-Durres, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga Pasaporta me nr BB2561938 dhe nr. Personal H51125006G

Mirakand FARRUKU, atesia Enver, lindur ne Manez - Durres me 18/04/1977 dhe banues ne Manez-Durres, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar nga Karta e Identitetit me nr.leternjoftimi 036491599 dhe nr. Personal H70418011Q

Kjo shoqeri pershtatet me Ligjin Nr.9901 dt.14/04/2008, "Per Shoqerite Tregtare", per te ushtruar veprimtari te perbashket sipas parashikimeve te bera ne kete Statut. Emertimi i shoqerise eshte **EMAV GROUP Sh.p.k**. Shoqeria e percaktuar ne nenin 1 te ketij statuti eshte krijuar me mjetet ne pronesi private te themeluesve te saj. Ajo regullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria **EMAV GROUP Sh.p.k** fiton personalitet juridik qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Shoqeria do te kete vulen e saj ne forme te zakonshme shkruar Shoqeria Private **EMAV GROUP Sh.p.k**.

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

NENI 2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete:

Objekti i shoqerise do te jete cdo aktivitet i lejuar nga Legjislacioni Shqiptar, vecanerisht sa me poshte:

1. Aktivitet ne fushen e turizmit, hapja dhe menaxhimi i hoteleve, godinave dhe ambienteve ne te cilat ushtrohet aktiviteti hoteljer.
2. Hapja dhe menaxhimi i qendrave te rekreacionit, me ose pa profil dermoestetikues, trajtim te lekures dhe trupit per masazhe, spa, mirembajtje trupore , fitnes, dhe pishina etj.
3. Kryerja e tregimit, prodhimit dhe perpunimit te mallrave qe kane te bejne me aktivitetin e hotelerise.
4. Hapja dhe menaxhimi i bareve , restoranteve brenda dhe jashte objektit te hotelerise.
5. Plazh privat.
6. Kryerja e operacioneve ekonomike dhe juridike, industriale , prodhuese , tregtare qe lidhen drejtperdrejt apo terthorazi me objektin e veprimtarise se shoqerise, brenda kuadrit te dispozitave ligjore per realizimin e cdo biznesi te pershtatshem ne arrijten e qellimeve te shoqerise.
7. Shoqeria mund te ushtroje gjithashtu edhe aktivitete te tjera ndihmese ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te konsideruara me perfitim e te dobishme per arrijten e objektivave te saj kryesore.

NENI 3. Selia

Shoqeria e ka Seline e saj ne: **Rruga Durres – Gjiri i Lalezit, Pasuria Nr.152/37, Zona Kadastrale 1522, Drac-Ishem- Durres**

Adresa e postes elektronike eshte : **info@emas.al**

Ajo mund te çele filiale, dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

NENI 4.

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.


KREU II-te

Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve:

NENI 5.

Ortaku gezon keto te drejta kryesore:

- Pjesmarrjen ne rezultatet e cdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne kontraten dhe statutin e saj.
- Marrjen e te gjitha te dhenave qe kane te bejne me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarine e shoqerise, si dhe me te gjitha dokumentat e perpunuara nga shoqeria, bilancet si dhe llogarite ekonomike, etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese se Ortakeve.
- Te heqi dore nga shoqeria.



- Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesve te tije ose vete.
- Te kerkoje t'i jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen prodhuese dhe tregtare te shoqerise, si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
- Te beje propozime dhe t'i paraqesi ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeruje dhe te shkarkojne perfaqesuesit e saj, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoren.

NENI 6.

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Te depozitojne kuoten e tyre dhe kuotat suplementare ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- T'i japin shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e cdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryejne detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- ortakët kanë te drejte te heqin dore nga shoqeria, duke i njoftuar vendimin e tyre asamblese se ortakëve ne rast shtimi te ortakëve 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes.
- Heqja dore nuk i liron ortakët nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqerise dhe nuk pezullon detyrimet e shoqerise ndaj ortakut.
- Ti japin shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryejne sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.
- Pjesemarrja ne shoqeri nuk i pengon ortakët te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie. Ata nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti i veprimtarise se saj tej kapitalit themelor ku ata kanë marre pjese.

KREU III-te

Kushtet Ekonomike dhe Kapitali themeltar

NENI 7.

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te leverdise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqerise nxirret brenda 31 Marsit te vitit pasardhes. Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

NENI 8.

Llogarite vjetore inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Pronaret. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 9.

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

NENI 10.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **150.000 (Njeqind e pesedhete mije) leke .**

Ortaku themelues Artur Enver Farruku zoteron 1(nje) kuote ose 33 % te kapitalit

Ortaku themelues Alban Enver Farruku zoteron 1(nje) kuote ose 34 % te kapitalit

Ortaku themelues Mirakand Enver Farruku zoteron 1(nje) kuote ose 33 % te kapitalit

NENI 11.

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave i marrin themeluesit.

Fitimi neto i realizuar nga shoqeria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj.perfitohen prej themelueseve te kesaj shoqerie.

Themeluesit perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te tij themeluesit kane te drejten e rritjes se tij.

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Shoqeria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqeria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Shoqeria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

NENI 12.

Shoqeria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejte te perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen. Shoqeria gezon te drejtat per mbrojtjen e pasurise se saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 13.

E ardhura bruto e shoqerise, pasi zbritet amortizimi i te gjithë pasurise se luajtshme e te paluajtshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese e energjine si dhe shpenzimet e pergjithshme te saksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese, i takojne ortakeve te shoqerise.

KREU IV-te Administrimi

NENI 14.

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve.

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga administratoret, nga eksperti kontabel i autorizuar. Mbledhja e Asamblese mblidhet dhe merr vendime ne baze te nenit 86 dhe 87 te ligjit Per Shoqerite Tregtare.

Sipas rendesise se vendimeve mbledhja e Asamblese mund te jete e **zakonshme** ose e **jashtezakonshme**.

Asambleja e zakonshme vendos :

1. Per çeshtje te tilla si emerim ose shkarkimin e personelit Menaxherial dhe teknik sipas strukturave te ngritura nga shoqeria ,ekspertin kontabel te autorizuar dhe likuiduesit, miratimin e raporteve te administrimit dhe kontrollit, per :
2. Miratimin e programit vjetor te veprimtarise se shoqerise.

Asambleja e jashtezakonshme vendos:

Per çeshtje te tilla si ndryshimin e statutit, zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar, zmadhimin e kapitalit themeltar, transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar, shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera, mbylljen e shoqerise para kohe, per fitimin dhe rezultatet


Asambleja thirret se paku nje here ne vit, duke lajmeruar me shkrim 30 dite perpara.

NENI 15

Asambleja e Ortakeve merr vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise



5



Kompetencat ekzekutive te Asamblese se Ortakeve te shoqerise jane:


1. Percaktimi i te drejtave kryesore te veprimtarise se shoqerise.
2. Ndryshimet ne emertesen e prodhimit qe do te realizohet dhe te punimeve qe do te kryhen, qe jane pjese perberese e objektit te veprimtarise se shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin baze te shoqerise.
4. Percaktimi i regjimit dhe i kushteve te zbatimit te parimeve te llogarise ekonomike.
5. Percaktimi i rregullave dhe i normave, qe perkufizojne raportet me gjirin e shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
6. Percaktimi i struktures se aparatit te shoqerise.
7. Percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese ndermjet perfaqesive te ortakeve.
8. Emertimi dhe zevendesimi i Administratorit te pergjithshem te shoqerise.
9. Krijimi i organeve te tjera te domodoshem per realizimin e objektivave te shoqerise.
10. Percaktimi i madhesis se kuotave per formimin e kapitalit baze te shoqerise.
11. Paraqitja e propozimeve per rregullimin, krijimin dh perfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimit per krijimin e filialeve te degeve e te perfaqesive si dhe per cedimin e veprimtarise se tyre.
13. Percaktimi i rregulloreve per proceduren e punes te administrates.
14. Pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
15. Perzgjedhja e antareve per komisionin e likujdimit te cilet emrohen dhe rievokohen nga Asamblea e Ortakeve.
16. Kryerjen e veprimtarive per likujdimin e llogarive, qe i perkasin ortakut doreheqes te shoqerise.
17. Marrjen e vendimit per kerkimin dhe perdorimin e kredive afatgjata.

NENI 16.

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj.
Ne shoqerine **EMAV GROUP Sh.p.k** administratori i shoqerise eshte, **Z. Artur FARRUKU**. Me miratimin e ortakeve mund te emerohen administratore dhe perfaqesues te shoqerise. Administratoret emerohen per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet me interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratoret jane pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

Kompetencat e administratoreve ne shoqeri jane:

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjen e asamblese kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.



- Te krijoje organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te propozoje ne mbledhjen e asamblese per krijimin e njesive, srukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimet per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqesin ato Asamblese per miratim.
- Te perzgjedhi ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit dhe te paraqesin propozimet per miratim ne asamble.
- Te siguroje zbatimin e perpikthe te vendimeve te asamblese.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.
- Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme, administron pasurine e shoqerise, duke perfshire ketu mjetet financiare, brenda caqeve te vendimeve te marra nga organi administrativ i shoqerise.
- Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.
- Perfaqeson shoqerine perpara te tretteve si gjykate, etj.
- Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e tyre ne jete.
- Merr te gjitha vendimet qe kane te bejne me ato veprimtari te shoqerise, qe nuk jane ne kompetence ekzekutive te Asamblese se Ortakut.
- Raporton dhe i pergjigjet Asamblese per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.
- Siguron drejtimin e shoqerise.
- Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretteve brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne unanimitetin e ortakeve ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Asamblese se Ortakut.
- Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Asamblese se Ortakeve.
- Ben hapjen e leter kredive ne leke e ne valute te huaj.

NENI 17.

Per te kontrolluar veprimtarine financiare te shoqerise e te filialeve te saj krijohet komisioni i revizionimit kontabel. Kryetari dhe antaret e ketij komisioni emerohen nga Asambleja e Ortakeve. Kryetari i komisionit emerohet per cdo mandat nga Asambleja. Komisioni i Revizionimit kontabel perbehet nga 3-5 vete dhe qendron ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh. Kryetari dhe antaret e komisionit nuk mund te jene ne varesi te shoqerise ose filialeve te saj. Komisioni i Revizionimit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet perpara Asamblese se Ortakeve dhe eshte i detyruar ti paraqese asaj cdo vit raport per kontrollet e bera si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

NENI 18.

Marredheniet e punes ne shoqeri.

Marrdheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionit shqiptar dhe me kete

statut si dhe nepermjet kontrates se punes Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes. Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes.

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes.

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare.

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.

Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e Punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.

Pushimi i marredhenies se punes.

Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Per te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e rrethit Gjyqesor Tirane.

KREU V-te

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

NENI 19

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper "

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagueuse, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.



NENI 20

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 21

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 22

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

NENI 23.

Ku statut hyn në fuqi menjëherë.

Durrës, më 01/08/2022

THEMELUESIT E SHOQERISE

EMAV GROUP SHPK

ORTAKU
ARTUR FARRUKU

ORTAKU
ALBAN FARRUKU

ORTAKU
MIRAKAND FARRUKU

Artur Farruku

Alban Farruku

MIRAKAND FARRUKU

